



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË  
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1066/4 Prot.

Vlorë më, 16.04. 2026

**VENDIM**

Nr. 27, datë 16.04.2026

**PËR AKORDIMIN E MBËSHTETJES FINANCIARE, NGA FONDI I VEÇANTË  
I UNIVERSITETIT "ISMAIL QEMALI", VLORË, ZNJ. HATIXHE LIKAJ**

Në mbështetje të nenit 49 të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"; ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"; ligjit nr. 87/2025 "Për buxhetin e vitit 2026"; pikës 1 të VKM-së nr. 493, datë 06.07.2011, "Për disa ndryshime në vendimin nr. 929, datë 17.11.2010 të Këshillit të Ministrave, 'Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë"; nenit 25, pika 1, shkronja "rr", të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë; Rregullores Financiare të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë; si dhe propozimit të Administratorit, ardhur me shkresën nr. 770/2 prot., datë 10.04.2026, në mbledhjen e datës 16.04.2026, Bordi i Administrimit,

**VENDOSI:**

1. T'i jepet ndihmë e menjëhershme për rast fatkeqësie, në masën 30,000 (tridhjetë mijë) lekë, znj. Hatixhe Likaj.
2. Efekti financiar i këtij vendimi do të përballohet nga fondi i veçantë i buxhetit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, për vitin 2026.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Administratori dhe Sektori Ekonomik i Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Anëtarët**

Orkida Hasani

Alma Bakiu

Enrik Mehmeti

Enida Pulaj

Elmira Kushta

**KRYETAR**

**Saniela Xhaferi**

